



**Observatori për të Drejtat e Fëmijëve**

**Raport studimor**

**“Situata e fëmijëve me nevoja të veçanta” për vitin 2012 - Qarku Gjirokastrë**



**Observatori Gjirokastrë  
Eksperte Ira Duri  
Prill 2014**

## LISTA E SHKURTIMEVE

Observatori	- Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
DSHP	- Drejtoria e Shëndetit Publik
DRSHSSH	- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
UNICEF	- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
OJF	- Organizata jo Fitimprurëse
FAK	- Fëmijë me Aftësi të Kufizuar
OMZH	- Objektivi i Mijëvjeçarit të Zhvillimit
MASH	- Ministria e Arsimit dhe Shkencës
DAR	- Drejtoria Arsimore Rajonale
ZA	- Zyre Arsimore
NJMF	- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
DRP	- Drejtoria Rajonale e Punësimit
PEI	- Program Edukativ Individual

## I - Parathënie dhe falenderime

“Observatori për të Drejtat e Fëmijës” është një organizatë jo qeveritare e mbështetur financiarisht nga UNICEF .

Observatori ka nisur si projekt të zbatohet që në *Mars të vitit 2009*. Aktualisht Observatori ka ngritur zyrat në rang kombëtar, në të 12 qarqet e Shqipërisë. Zyra e Observatorit, harton raporte bazuar në realizimin e të drejtave të fëmijëve me shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke u mbështetur në analizën e *140 treguesve* të ndryshëm.

Observatori Gjirokastër ka ngritur urat e bashëpunimit me të gjitha institucionet, drejtoritë, strukturat vendore dhe lokale OJF, Qendra ditore, të cilat kanë në fokusin e tyre fëmijët. Mund të përmendim disa prej tyre: Drejtorinë Arsimore Rajonale, ZA-të e rretheve ,Drejtorinë e Shëndetit Publik, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastër, Drejtorinë e Policisë, OJF të ndryshme si dhe bashkëpunimi ndërmjet Bashkive dhe Komunave të qarkut Gjirokastër.

Në rajonin e Gjirokastrës, Observatori ushtron veprimtarinë e tij që në Tetor të vitit 2010. Përveç mbledhjes së treguesve të drejtave të fëmijëve në sektorë të ndryshëm, si: arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale apo mbi të drejtën për pjesëmarrje, Observatori Gjirokastër ka realizuar së fundmi studimin me temë “**Arsimimi, integrimi dhe gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta**” për vitin 2012. Ky studim vjen si një studim i bazuar në të dhënat e grumbulluara kryesisht nga 3 rrethet në Qark,- Gjirokastër, Tepelenë, Përmet dhe gjithashtu nga të dhënat, statistikore, sasiore dhe cilësore të ardhura nga institucionet rajonale të qeverisjes vendore, Qendra Ditore, informacione dhe biseda në komunitet nga organizatat e shoqërisë civile të cilat në fokus kanë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Studimi synon paraqitjen e tablos të gjendjes së Fëmijëve me “**Nevoja të veçanta**” për vitin 2012 për Qarkun Gjirokastër. Për realizimin e këtij studimi janë përzgjedhur të tre rrethet e qarkut Gjirokastër për shkak të numrit të lartë të personave me **Nevoja të Veçanta**. Gjithashtu problemet sociale me të cilat përballen fëmijët me nevoja të veçanta janë të mprehta dhe akoma nuk ka një vëmendje të veçantë të treguar, qoftë edhe nga pushteti lokal dhe qendror për të përmirësuar jetën e fëmijëve me nevoja të veçanta . Këtë fakt e tregon mungesa e buxheteve të veçanta për këtë kategori fëmijësh, mungesa e zbatimit të politikave të strategjive dhe të drejtave që e karakterizojnë këtë kategori .

Observatori Gjirokastër dëshiron të falenderojë për gjithë informacionet e vyera të dhënë në kuadër të realizimit të këtij studimi, të gjithë profesionistët e institucioneve rajonale të kontaktuar, edukatorë dhe mësues, drejtues të Qendrave Ditore,të cilët synojnë integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në edukim dhe zhvillim personal dhe profesional. Gjithashtu një falenderim i veçantë shkon për UNICEF-in i cili na mbështet financiarisht, stafin e zyrës së Observatorit Tiranë, znj.Elma Tërshana, (Drejtoreshë projekti), Znj Mina Mata (Administratore kombëtare e të dhënave) Ermira Zaçe (Financiere) ,konsultimi me kolegët në grup për mbështetjen dhe këshillimet e vazhdueshme gjatë fazës së hartimit të këtij studimi.

*Ju faleminderit !*

## II - Hyrja

**Qarku i Gjirokastrës** është një nga 12 qarqet e Shqipërisë Qarku i Gjirokastrës përfshin rrethin e Gjirokastrës, rrethin e Përmetit dhe rrethin e Tepelenës. Qarku i Gjirokastrës kufizohet në veri me Qarkun e Beratit, në veriperëndim me Qarkun e Fierit, në jug deri në perëndim me Qarkun e Vlorës, në juglindje me Greqinë dhe në lindje me Qarkun e Korçës.

Ndryshimet social-ekonomike që kanë ndodhur në dhjetëvjeçarin e fundit janë shoqëruar me problematika të reja shoqërore, të cilat kanë sjellë pasoja në koston shoqërore për individë të pambrojtur, për familjet e tyre dhe komunitetet me nevoja të ndyshme .

Në Qarkun Gjirokastrë nga bisedat e zhvilluara me specialistë të DSHP Gjirokastrë, është vënë re rritja e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, sidomos i fëmijëve me spektrin e autizmit , sindromën dawn,dhe paraliza spastike<sup>1</sup> .

*Qëllimi* i këtij raporti është paraqitja e situatës të *fëmijëve me nevoja të veçanta* , identifikimi i respektimit i të drejtave të fëmijëve me nevoja të veçanta përmes monitorimit dhe vlerësimit të situatës në nivel lokal si dhe nevojave jetike të kësaj kategorie për integrimin e tyre për vitin 2012 në Qarkun Gjirokastrë. Çdo individ i shoqërisë sonë gëzon dhe duhet t'i garantohen të drejtat bazë për arsim, shërbime shoqërore dhe integrim në shoqëri<sup>2</sup>.

Ky raport *synon* të identifikojë praktikatat ekzistuese, politikatat ,strategjitë ,shërbimet e ofruara, si dhe ndërjegjësimin e institucioneve për një menaxhim sa më të mirë të politikave dhe praktikave ekzistuese për këtë kategori si dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës lidhur me respektimin e të drejtave të tyre. Ky raport studimi do t'ju vijë në ndihmë Qendrave Rezidenciale të fëmijëve me nevoja të veçanta, Bashkive/ Komunave përkatëse ku ndodhen këto qendra rezidenciale, si dhe të gjithë komunave dhe bashkive në Qarkun Gjirokastrë. Realizimi i këtij studimi mund t'u shërbejë Institucioneve të pushtetit vendor për të përmirësuar kushtet dhe standardet e jetesës së fëmijëve me nevoja të veçanta. Gjithashtu, ky studim mund t'i shërbejë dhe donatorëve të ndryshëm dhe personave të tjerë të interesuar për të përmirësuar situatën e të drejtave të fëmijëve me nevoja të veçanta , duke synuar integrimin e plotë të këtyre fëmijëve në jetën sociale.

### Target grupi

Target grupi i përfshirë në këtë studim janë fëmijë të moshës 0-18 vjeç me nevoja të veçanta në njësitë vendore të qarkut Gjirokastrë dhe shërbimet e ofruara drejtëpërdrejtë për këtë kategori.

---

<sup>1</sup> Burim informacioni DSHP Gjirokastrë

<sup>2</sup>Raport “ realizimi i të drejtave të Fëmijëve në Shqipëri 2008-2009” Aleanca Kombëtare për Fëmijët/ Observatori Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve, 2010

## **Metodologjia**

*Ky studim u mbështet në interpretimin e të dhënave sasiore , cilësore,nga institucione të cilat ushtrojnë politikat e tyre në shërbim të kësaj kategorie, shqyrtimi i të gjitha dokumenteve strategjike kombëtare dhe lokale, shqyrtimi i ligjeve në fuqi, intervista me aktorë të ndryshëm kyç të institucioneve lokale si dhe shërbimet e ofruara për këtë target grup,në Qarkun Gjirokastrë.*

Metodologjia e përdorur për këtë studim ka qenë e ndërthurur midis informacionit në institucionet rajonale, qendra ditore të cilat ofrojnë shërbime ,OJF të cilat operojnë në Qarkun Gjirokastrë dhe identifikimi i situatës në terren. Një rëndësi të veçantë në këtë studim i'u dha takimeve, intervistave, bisedave me drejtorët e shkollave , mësueseve të shkollave të arsimit gjithëpërfshirës, drejtorë dhe specialistë të SHP, drejtorë dhe inspektorë të DAR dhe ZA-ve në rrethet Tepelenë dhe Përmet, zyrës NJMDF Bashkia Gjirokastrë ,NJDF në Qark, drejtorë dhe inspektorë të DRSSHSSH, biseda të drejtpërdrejta me fëmijë me nevoja të veçanta, prindër të fëmijëve të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës, psikologë shkollash të cilët vëzhgojnë ecurinë e fëmijës.

Të dhënat statistikore u përpunuan sipas këndvështrimit të drejtave të fëmijëve me nevoja të veçanta si pjesë e të drejtave të fëmijëve <sup>3</sup>.

Një seri *dokumentash*, u konsultuan gjatë fazës Desk Review si më poshtë:

- Strategjia Kombëtare e personave me Aftësi të Kufizuara 2004 – 2015
- Ligji për arsimin parauniversitar
- Konventa mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar
- Konventa mbi të drejtat e fëmijës.
- Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013 ,Raport progresi 2008-2009 (Mars 2010) , Hartuar nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe UNICEF.

Në këtë studim janë trajtuar disa çështje kryesore, të cilat sollën një paraqitje sa më reale të zbatimit të praktikave, strategjive dhe standardeve të fëmijëve me nevoja të veçanta të Qarkut Gjirokastrë.Studimi u përfshi në 3 bashkitë e rrethit të Qarkut Gjirokastrë si dhe në shkollat e arsimit gjithëpërfshirës Gjirokastrë.

**Në këto njësi u kontaktuan përfaqësues të institucioneve të cilat kanë në fokus fëmijët,u vëzhguan Qendra Ditore, të cilat ofrojnë shërbime në Qark,si dhe vëzhgime në shkolla të arsimit gjithëpërfshirës ,kopshte shtetërore dhe private.**

- 10 individë përfaqësues të 7 institucioneve,(DAR,ZA,DSHP,Bashki,Qark,DRFP, DRSSHSS)
- 10 pyetësorë të hapur me pyetje të hartuara për secilin institucion .
- Vëzhgime në 2 Qendra Ditore të qarkut Gjirokastrë
- Vëzhgime në 2 shkolla të arsimit gjithëpërfshirës
- Vëzhgime në 2 kopshte (shtetërore dhe private).

---

<sup>3</sup> Ligji 10347, date 4.11.2011 " Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës"

*Çështjet që u trajtuan në këtë studim u paraqitën në formën e pyetësorëve , intervistave në grup, bashkëbisedimeve individuale në terren, intervista, vëzhgime në institucione, qendra ditore ,ku të gjithë këta komponentë, ndikojnë drejtëpërdrejtë në integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.(Çështjet që u trajtuan në këtë studim do t'i gjeni te Aneksi nr1 )*

### **Gjatë fazës së studimit u hasën vështirësi dhe limitime :**

- Mungesa e të dhënave statistikore për fëmijët me nevoja të veçanta në institucione.
- Mungesa e të dhënave statistikore mbi ndarjen e buxheteve që shkojnë direkt për këtë kategori.
- Mungesa e strategjisë së zhvillimit për fëmijët me AK të Qarkut Gjirokastrër.
- Mungesa e praktikave konkrete për këtë kategori .
- Pamundësia për të kontaktuar nga afër prindër të fëmijëve me Nevoja të veçanta, të cilët ndodhen në njësi vendore të largëta nga qendra e Gjirokastrës , e cila do të paraqiste një tablo të situatës dhe nevojave që kanë fëmijët me nevoja të veçanta që jetojnë në njësi të vogla vendore siç janë komunat dhe mini bashkitë.

### **1. III- Analiza e studimit për Fëmijët me “nevoja të veçanta”**

Qarku i Gjirokastrës ka një sipërfaqe prej 2,884 km<sup>2</sup> me një popullsi të regjistruar prej 153,885 banorë të vendosur në 42,660 familje<sup>4</sup> dhe me një dendësi popullore prej 53 banorë /km<sup>2</sup>. Krahasuar me vitin 2011 ka një rënie popullore prej 1% (559 banorë)<sup>5</sup>. Numri i popullsisë së grupmoshës 0-18 vjeç për vitin 2012 është 33,508 banorë ose 21.7 %<sup>6</sup> e popullsisë totale të Qarkut Gjirokastrër .

*Personat me Aftësi të Kufizuara” janë ata persona të cilët funksionet fizike, kapaciteti mendor ose gjendja psikologjike kanë prirje të shmangen për më shumë se gjashtë muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse, gjë që sjell për pasojë kufizime të pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore.(“Strategjia Kombëtare e personave me aftësi të kufizuar 2004-2015)*

Përqindja e fëmijëve (0-18 vjeç) me nevoja të veçanta në qarkun e Gjirokastrës ka ardhur në rritje. Në vitin 2011 përqindja e fëmijëve me nevoja të veçanta është 1% (326 fëmijë)<sup>7</sup> ndërsa në vitin 2012, përqindja e fëmijëve me nevoja të veçanta është 1.04 % (348 fëmijë). Nëse bëjmë një krahasim mes numrit të fëmijëve që jetojnë në zonë urbane me ato në zonë rurale, rezulton se 163 fëmijë jetojnë në qytet dhe 185 fëmijë me aftësi të kufizuar (0-18 vjeç) jetojnë në fshat.

<sup>5</sup> Zyra e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme,2013

<sup>5</sup>Zyra e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme,2013

<sup>6</sup>Zyra e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme,2013

Numri më i madh i fëmijëve me aftësi të kufizuara përbëhet nga grupmosha 6-15 vjeç (180 mijë), duke u pasuar nga grupmosha 15-18 vjeç (97 fëmijë) dhe në fund grupmosha 0-6 vjeç (70 fëmijë).

**Tabela 1 :** Numri FAK ndarë sipas grupmoshave dhe zonave urbane/rurale Qarku Gjirokastrë  
Përbërë nga 6 bashki dhe 26 komuna

**Burimi:** “Shërbimi Social Shtetëror Gjirokastrë” 2012;

Përlllogaritja është realizuar nga Zyra e Observatorit Gjirokastrë.

Zona	Nr total i fëmijëve 0-18vjeç	Nr total i FAK 0-18vjeç	Nr. i FAK 0-6 vjeç	Nr. i FAK 6-15 vjeç	Nr. i FAK 15-18 vjeç	% e FAK
<b>Bashkitë</b>	14,815	163	27	94	42	1.10%
<b>Komunat</b>	18,693	185	43	86	55	0.99%
<b>Totali</b>	33,508	348	70	180	97	1.04%

Duke ju referuar *Tablës nr 1* vëmë re se në grupmoshën 0-18vjeç fëmijë me AK në Qarkun Gjirokastrë janë 348 fëmijë .Nga këta 1.10%(163) fëmijë me AK jetojnë në zonat urbane dhe 0.99% (185) fëmijë me AK jetojnë në zonat rurale. Pra vëmë re se nr më i lartë i fëmijëve me AK është në zonat rurale me 53% .Kjo përlllogaritje vjen nga informacione zyrtare të marra nga DRSHSH Gjirokastrë të cilët janë vetëm për ata persona që kanë raporte mjeko-ligjore sipas diagnozës përkatëse .

Nga intervistat në terren, bisedat e zhvilluara me psikologë shkollash , mësues ,isnpektorë shëndetësie ,arsimi kanë dhënë informacione se ka dhe fëmijë të tjerë të padiagnostikuar, për arsye të disa faktorëve si: banorë të zonave të thella , largësia e institucioneve përkatëse qendrore, infrastruktura jo e përshatëshme ,si dhe gjendja ekonomike e familjes.

Duke ju referuar *tabelës.2* , mund të themi se numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë të regjistruar në sistemin arsimor,janë 187 (ose 47%). Nga këto 33 fëmijë (ose 17.7%) janë në arsimin parashkollor, 118 fëmijë (ose 63.4%) në arsimin e detyruar dhe 36 fëmijë (ose 19.4%) në arsimin e mesëm. Pjesa tjetër e këtyre fëmijëve nuk janë të integruar në sistemin arsimor.


**Tabela 2 :** Numri i fëmijëve me AK që janë në sistemin arsimor dhe jashtë tij për vitin 2012

**Burimi:** DRSHSSH Gjirokastrë.

Zona	Nr total i fëmijëve 0-18vjeç	Nr. total i FAK	Nr. i FAK qe ndjekin shkollën	Nr. FAK që nuk ndjekin shkollën	Para shkollor	9- vjeçar	I mesëm
<b>Gjirokastrë</b>	16,271	102	28	75	8	16	4
<b>Tepelenë</b>	9,616	152	101	51	14	71	16
<b>Përmet</b>	7,621	94	58	36	11	31	16
<b>Totali</b>	33,508	348	187	162	33	118	36

Në paraqitjen grafike të mëposhtme, jepen të detajuara për të tre rrethet e Qarkut Gjirokastrë përkatësisht Fëmijët me Aftësi të Kufizuar, të cilët janë të regjistruar në arsimin parauniversitar, si dhe ata fëmijë të cilët nuk e ndjekin shkollën.

**Grafiku:** FAK në Qarkun Gjirokastrë, të cilët frekuentojnë arsimin Parauniversitar  
**Burim:**DRSHSSH Gjirokastrë Dhjetor 2012



Siç e vëmë re nga paraqitja grafike në rrethin Gjirokastrë fëmijët me AK të cilët janë të regjistruar në arsimin parauniversitar janë 102 fëmijë ,nga këta vetëm 28 e frekuentojnë shkollën ndërsa 75 fëmijë nuk e frekuentojnë . Në rrethin e Tepelenës 152 fëmijë me AK janë të regjistruar në arsimin parauniversitar ,nga këta 101 fëmijë e frekuentojnë shkollën ndërsa 51 fëmijë nuk e frekuentojnë. Në rrethin Përmet 94 fëmijë me AK janë të regjistruar në arsimin parauniversitar,58 fëmijë e frekuentojnë shkollën ndërsa 36 fëmijë nuk e frekuentojnë shkollën.Në të tre rrethet e Qarkut Gjirokastrë janë të regjistruar 348 fëmijë me AK në arsimin parauniversitar dhe nga këta 162 fëmijë nuk e ndjekin arsimin Pra, vihet re një shifër e konsiderueshme e mospërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim parauniversitar . Nga grafiku duket qartë se në rrethin e Tepelenës ka një numër më të lartë të fëmijëve me AK Rritja e numrit të FAK vjen për arsye të mungesës së informacionit ,ndotjes mjedisore e cila është më e perqëndruar në rrethin e Tepelenës në të cilat ndodhen minierat të cilat kanë patur një ndikim serioz në jetën e banorëve të kësaj zone, nivelin e ulët të jetesës, infrastrukturën, mungesën e shërbimeve .Të gjithë komponentët e mësipërm ndikojnë në mosdiagnostikimin e hershëm të sëmundjes dhe trajtimin sa më efikas të saj.

*“Fëmija me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike gëzon përkujdesje të veçantë e cila jepet falas nga autoritetet shtetërore . Ky përkujdes i veçantë përcaktohet për ti siguruar fëmijës me aftësi të kufizuara qasje efektive në arsimim , trajnim, shërbime të kujdesit shëndetësor, shërbime të rehabilitimit përgatitje për punësim dhe argëtim ,duke zhvilluar mundësitë e tij individuale në mënyre të favorshme për arritjen e integritit të plotë të mundshëm social, kulturor dhe shpirtëror.” Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, Neni 30 .*



Qeveria Shqiptare në vitin 2004 krijoi një strategji gjithëpërfshirëse dhe të re në fushën e arsimit për periudhën 2004-2015. Kjo strategji, ka integruar më së miri OMZH-të, "Arsim për të Gjithë", dhe ka vendosur shumë prioritete me qëllime gjithëpërfshirëse.

Në këtë studim janë përfshirë 2 shkolla 9-vjeçare të arsimit gjithëpërfshirës të qytetit Gjirokastrë ku fëmijët me nevoja të veçanta ndjekin klasa normale dhe për secilin fëmijë hartohen plane edukative individuale (PEI), të cilat bëjnë të mundur edukimin dhe zhvillimin e fëmijës, në arsimin parauniversitar. Nga të dhënat e DAR Gjirokastrë ka 18 fëmijë me nevoja të veçanta, të cilët ndjekin kopshtet normale dhe arsimin gjithëpërfshirës.

Në Ligjin e ri të arsimit parauniversitar, parashikohet krijimi i komisioneve shumë-disiplinore rajonale<sup>8</sup> me mandatin e vlerësimit të kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara; një komision i cili gjithashtu sugjeron nëse fëmija mund të integrohet në shkollë normale apo në "shkollë të veçanta". Komision shumë-disiplinor tashmë është krijuar në DAR Gjirokastrë të përbërë nga 5-anëtarë:

- Mjek Pediatër
- Përfaqësues të pushtetit lokal
- Psikologë
- Mësues
- Prindër

Në ZA-të Tepelenë dhe Përmet, komisioni multidisiplinor nuk është finalizuar ende, por është primare në realizimin e objektivave për një krijim dhe mbështetje sa më të shpejtë të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Edhe pse ligji e përmend qartë ngritjen dhe funksionimin e këtij komisioni shumë-disiplinor ende nuk janë krijuar plotësisht këto komisione dhe nuk ka një të dhënë të saktë se sa fëmijë kanë përfituar nga ky komision. Të dhënat lidhur me Komisionin shumë - disiplinor mungojnë në ZA Tepelenë dhe Përmet, kjo si rrjedhojë e ndërrimeve të stafëve lokale; Drejtuesit e rinj shprehën se kanë mungesë informacioni mbi funksionimin e mëparshëm apo për ekzistencën e këtij Komisioni.

Gjithashtu bazuar dhe parashikuar në nenin 44 të po këtij ligji, Kurrikula të veçanta duhet të zhvillohen për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke marrë parasysh zhvillimin fizik, social dhe mendor të fëmijës, si dhe kapacitetet individuale të çdo rasti. Në vazhdim të këtij ligji deklarohet se edukimi i fëmijëve në shkollë të veçanta duhet të jetë i përkohshëm<sup>9</sup>, ndërsa integrimi në shkollë normale është themelore dhe duhet të jetë i përhershëm. Gjithashtu ZA-ve u lind përgjegjësi e parashikuar në nenin 64 se duhet të ndërtojnë një komision të veçantë të përmendur më lart, tashmë ekzistues në DAR Gjirokastrë. Prindi, luan një rol kyç në integrimin e fëmijës i cili vendos nëse fëmija ndjek shkollën speciale apo arsimin normal. Prindi është i përfshirë dhe në hartimin e programit edukativ individual (PEI) në shkollë. Prindi ndjek hap pas hapi zhvillimin e fëmijës së bashku me psikologun e shkollës, mësuesen kujdestare dhe drejtorin e shkollës.

Ky plan përgatitet nga një komision i përbërë nga:

- Psikologu

---

<sup>8</sup> Ligji nr.69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar" neni 5 " E drejta për Arsimim" dhe neni 6 "Parimet e përgjithshme për edukimin e fëmijëve

<sup>9</sup>Neni 63, Ligjit nr.69 /2012 Për Arsimin Parauniversitar.

- Prindi
- Mësuesi kujdestar
- Drejtuesi i shkollës.

Fëmijëve me aftësi të kufizuar duhet t'u garantohet një mësues asistent dhe shërbime rehabilituese. Stafit arsimor që punon me këta fëmijë duhet të jetë i trajnuar dhe liçensuar (çertifikuar) nga MASH.

Nga të dhënat e DAR Gjirokastrë ka mësuese të trainuara ,kualifikuara nga MASH në bashkëpunim me SAVE THE CHILDREN dhe MEDPAK,në shkollat 9-vjeçare të arsimit gjithëpërfshirës të cilat punojnë me fëmijët me nevoja të veçanta .

Ndërsa në ZA-të e rretheve nuk ka asnjë të dhënë për programe PEI për fëmijët me nevoja të veçanta.Në Qarkun Gjirokastrë nga studimi rezulton se nuk ka shkolla speciale për fëmijët me nevoja të veçanta dhe FAK mund të frekuentojnë vetëm shkollat e arsimit gjithëpërfshirës.

Në vitin 2011 u zbatua inisiativa e organizatës MEDPAK(OJF), e cila mbështeti fëmijët me nevoja të veçanta duke ju krijuar shërbime ,praktika të mirëfillta për integrimin në shoqëri. Përgjatë zbatimit të projektit kjo organizatë mundësoi një mësuese lehtësuese në shkollat e qytetit me zbatimin e programeve PEI për secilin fëmijë. Zbatimi i këtij projekti dha një impakt të menjëhershëm dhe të dukshëm të ecurisë së fëmijëve me probleme. Ky projekt kishte ngritur një grup vlerësimi në bashkëpunim me DAR dhe nga ky grup kanë përfituar 7 fëmijë me nevoja të veçanta<sup>10</sup>

Ligji i ri i Arsimit Para-Universitar i përmendur më lart gjithashtu thekson se rastet e veçanta, fëmijët me aftësi të kufizuar , duhet të përfitojnë nga shërbimet arsimore alternative. Sipas Ligjit nr. 69/2012 “Për arsimin parauniversitar” këto shërbime përfshijnë shërbime psikologjike në institucionet e arsimit<sup>11</sup>.”

Në lidhje me përkujdesin shoqëror dhe social të fëmijëve me aftësi të kufizuar, është dhe udhëzim<sup>12</sup> i MASH (Ministria e Arsimit dhe Shkencës), i cili synon të sigurojë shërbime psikologjike dhe sociale në shkolla

Ky shërbim në Qarkun Gjirokastrë është i mundur vetëm në zonat urbane me një psikolog në arsimin parauniversitar dhe një në arsimin e mesëm .Ky shërbim ushtrohet vetëm në shkollat kopshtet e qytetit.Në zonat rurale është evident mungesa e shërbimit.

Në Qarkun Gjirokastrë operojnë 10 organizata lokale , të cilat kanë në fokus fëmijët dhe disa organizata kombëtare dhe ndërkombëtare me shërbime të drejtëpërdrejta për këtë target grup.

Vlen të përmendim MEDPAK ,Save the children, Terre des Hommes, Zgjidhja e Konflikteve të cilat kanë zbatuar praktika të frytshme me fëmijet,prindërit,komunitetin dhe stafet arsimore .

**-Një komponent kryesor në integrim të *fëmijëve me nevoja të veçanta* janë dhe shërbimet e ofruara për fëmijët në Qarkun Gjirokastrë:**

<sup>10</sup> DAR Gjirokastrë

<sup>11</sup> Neni 20 Ligji për Arsimin Parauniversitar, 2012

<sup>12</sup> Udhëzimi Nr.18 datë 21.04.2008 “Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar”

Në qarkun Gjirokastrë janë 2 qendra ditore të cilat ofrojnë shërbime vetëm për fëmijë me nevoja të veçanta .

Qendra Ditore “ Fëmijët Autik” në Gjirokastrë hapur në prill të vitin 2012 dhe Qendra Ditore “ Dora e Ngrohtë” hapur në vitin 2008 në Qytetin e Tepelenës të cilat ju ofrojnë shërbime zhvilluese fëmijëve me nevoja të veçanta. Në këto dy qendra u zhvilluan pyetësore të hapur dhe u realizuan vëzhgime për të njohur funksionin e tyre.

#### **-Qendra e fëmijëve Autik Qarku Gjirokastrë.**

Qendra e fëmijëve autik Qarku Gjirokastrë është hapur në Prill të vitit 2013. Në këtë qendër marrin shërbim 30 fëmijë me spektrin e autizmit dhe sindromën daun. Kjo qendër ka një staf të përbërë nga:

- 4 logoterapist
- 2 Pedagog zhvillimi
- 1 Punonjës social
- 1 Psikolog
- 3 Edukator zhvillimi

Qendra ofron kushte bashkëkohore , favorizuese , përkushtim të stafit të kualifikuar për një edukim dhe zhvillim sa më efikas të fëmijëve.Nga takimet e realizuara me kordinatoren pranë kësaj qendre morëm informacion se moshja e fëmijëve që marrin trajtim në këtë qendër janë nga 03-14 vjeç ,nga këta 23 fëmijë marrin shërbime sipas diagnozave të percaktuara nga instucionet përgjegjëse ,dhe njëkohësisht ndjekin dhe arsimin parashkollor . Ndërsa 7 fëmijë marrin vetëm terapinë në qendër dhe për arsye të rëndë shëndetësore nuk ndjekin arsimin.

Kjo qendër ditore është e mbështetur nga *Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë* në bashkëpunim me organizatën jo qeveritare lokale “*Qendra Komunitare Multifunksionale*” dhe menaxhuar nga *Këshilli i Qarkut Gjirokastrë*

#### **-Qendra ditore “Dora e ngrohtë”**

Kjo qendër ndodhet në qytetin e Tepelenës ka një kapacitet prej 50 personash dhe numri i klientëve është 22.Në këtë qendër marrin shërbim persona nga 09- 35 vjeç nga këta 15 janë fëmijë të moshës 9-18 vjeç.Pjesa më e madhe është nga qyteti dhe një pjesë e vogël vjen nga fshtrat përreth, me diagnoza paaftësi të lehta fizike dhe paaftësi të lehta mendore. Shoqata “Dora e Ngrohtë” është një shoqatë kombëtare humanitare, jo- fitimprurëse në Shqipëri në shërbim të personave me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike me qendër në Tepelenë. Gjithashtu, shoqata ju vjen në ndihmë dhe personave me aftësi të kufizuar dhe familjeve në nevojë si dhe ka bashkëpunuar në shërbime të ndryshme në ndihmë të komunitetit . Dora e Ngrohtë ka degët e saj në Pogradec, Korçë, Përenjas, Delvinë, Sarandë, Elbasan, Himarë, Laç

Kjo Qendër ka ambjente bashkëkohore mësues të trainuara, të kualifikuar psikologë, punonjës socialë të cilët punojnë në mënyrë të përkushtuar për zhvillimin e personave me AK përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre . Puna e përkushtuar gjatë vitit 2012 u finalizua me hapjen e një ekspozite me punimet e fëmijëve me AK të qendrës në Galerinë e Arteve në Tiranë.

Po në këtë vit janë shpërndarë karroca me rrota dhe motorrë me bateri me financim nga kisha Engjëlllore Hollandë . Në qendër nuk jepen shërbime të specializuara si logopedi, fizioterapi .

Drejtori i kësaj qendre shprehet se ka shumë fëmijë të tjerë në rrethin e Tepelenës të cilët nuk ekspozohen nga prindërit për shkak të informimit dhe paragjytimeve që ata kanë . Qendra punon me vetëfinancim të cilën e bën shumë të vështirë funksionimin e saj.

#### **IV - Prezantimi i gjetjeve kryesore ( Sasiore dhe cilësore)**

Përgjatë studimit është evidentuar se fëmijët me pamundësi fizike u kufizohet ndjekja e arsimimit për shkak të mungesës së infrastrukturës e cila nuk ekziston në asnjë shkollë të Qarkut Gjirokastrë. Mungesa e rampave në të gjitha institucionet apo qendrat shëndetësore të cilat bëjnë të pamundur moskryerjen e shërbimeve vetijake .

Fëmijët me aftësi të kufizuar dhe prindërit e tyre duket se ndeshen shpesh dhe me paragjykimet negative të shoqërisë duke mos i ekspozuar fëmijët por i mbajnë të izoluar në shtëpitë e tyre,dhe duke mos marrë asnjë shërbim. Ky fakt është më i përhapur në zonat rurale.Nga bisedat me fëmijët dhe prindërit , fëmijët me nevoja të veçanta shpesh përbuzen nga shoqëria për shkak të karakteristikave të tyre. Ka fëmijë të cilët arrijnë të mos e frekuentojnë shkollën vetëm nga ky problem .

Nga studimi është vërtetuar se 80% e fëmijëve me nevoja të veçanta frekuentojnë vetëm arsimin e detyrueshëm dhe më pas qëndrojnë në familje duke mos marrë asnjë shërbim për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre . Nga informacioni i marrë në shkolla dhe DAR nuk kishte kurrikula të veçanta për trajtimin e fëmijëve me probleme.

#### **-Një rol të rëndësishëm luan dhe shërbimi shëndetësor .**

Sipas të dhënave të marra nga DSHP Gjirokastrë numri i të diagnostikuarve është rritur dhe faktorë për këtë janë lindjet mbi 35 vjeç dhe nën 18 vjeç ,stili i keq i jetësës ,stresi, kequshqyerja,duhani përdorimi i lëndëve narkotike, kontakti jo i shpeshtë me mjekun e familjes, mungesa e fushatave të shpeshta sensibilizuese,informuese (sidomos në zonat e thella rurale) . Të gjithë këta faktorë sjellin një shëndet me probleme dhe një diagnostikim jo në kohën e duhur .

Nga burime zyrtare të DSHP-së përgjatë periudhës 2012 janë rritur rastet e fëmijëve të diagnostikuar me sindromin Daun, autizëm,paraliza spastike ,46 raste janë identifikuar në bashkinë Gjirokastrë. Trajtimi i këtyre fëmijëve bëhet në qendra të specializuara në Tiranë dhe jashtë shtetit pasi në këtë rreth mungojnë shërbimet e specializuara .

Nga të dhënat e DSHP Gjirokastrë mamitë e patronazhit për vitin 2012 kanë realizuar 130 vizita në familje, me fëmijë të porsalindur duke dhënë asistencën teknike për një ushqyerje sa më të shëndetëshme të fëmijës . Përgjegjësit e këtij institucioni shprehin shqetësimin se mungojnë shërbimet psiko-sociale dhe rehabilituese për fëmijët me nevoja të veçanta dhe prindërit detyrohen të shkojnë në qendra të specializuara për diagnostikim apo trajtim të mëtejshëm. Në qytetin e Gjirokastrës nga DSHP janë realizuar nje sërë aktivitete. Gjatë vitit 2012-2013 janë zhvilluar trainime ,aktivitete sensibilizuese dhe informuese me komunitetin janë shpërndarë fletëpalosje postera. Ndërgjegjësimi i komunitetit luan një rol të rëndësishëm për një shëndet sa më të kujdesshëm dhe të mirë .Ky ndërgjegjësim vihet re vetëm në Gjirokastrë por në zonat përreth saj mungon ky informacion dhe shërbim.

**Ligji nr. 8872, dt. 29. 03. 2002**, "Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë",  
përfshin rregulla për trajnimin dhe formimin profesional, dhe personat me aftësi të kufizuara janë ndër përfituesit kryesorë të këtij ligji. Personave me aftësi të kufizuara ky ligj u siguron mundësinë e përgatitjes profesionale falas në qendrat publike dhe me pagesë në kurset private.  
*Strategjia e PAK 2004-2015*

-Nga takimet në institucionin e Formimit Profesional në Gjirokastrë nuk ishte asnjë fëmijë me nevoja të veçanta i përfshirë në kurset e ofruar nga kjo qendër për vitin 2012.

-Në qarkun Gjirokastrë mungojnë vendet e argëtimit për aktivitetet social –kulturore të cilat ndikojnë në formimin dhe zhvillimin në veçanti të kësaj kategorie.

#### **Një komponent i rëndësishëm është dhe pjesmarja e këtij target grupi në vendimmarrje:**

**Parimi i Vetëvendosjes** vjen nga përqasja me të drejtat civile dhe nënkupton që mjedisi ku jetojnë personat me aftësi të kufizuara duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që t'i inkurajojë ata të jetojnë një jetë të pavarur dhe të jenë të aftë të vendosin vetë. Vetëvendosja ka të bëjë gjithashtu me të drejtën për të menaxhuar lëvizjet, kohën dhe pasurinë individuale.  
*(Strategjia Kombëtare PAK 2004-2015)*

Parimi i mësipërm deri tani nuk ka gjetur zbatim sepse ka shumë bariera që e pengojnë dhe për shkak të karakteristikave që e karakterizojnë këtë kategori .

## Rekomandime

- Rekomandojmë që ky studim me gjetjet e veta përkatëse ,të mund të shërbejë si një iniciativë për një Strategji dhe Plane Veprimi në nivel Qarku për fëmijët me aftësi të kufizuar, sipas fushave përkatëse të të Drejtave të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar.
  - Një rol të rëndësishëm në këtë këndvështrim duhet t'u jepet njësive të pushtetit vendor sidomos Këshillit Bashkiak dhe Këshillit të Qarkut, të cilat kanë mundësinë dhe detyrimin ligjor për të ngritur struktura përkatëse për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe ofrimin e shërbimeve për ta.
- Rritja e efikasitetit të komisionit Multidisiplinar pranë DAR dhe ZA-ve .
- Integrimi i fëmijëve në kopshte dhe shkolla.
- Infrastrukturë të përshtatshme në institucione për të lehtësuar lëvizjet jetike të kësaj kategorie
- Mësuese lehtësuese për fëmijët me nevoja të veçanta për të pasur një zhvillim dhe edukim më të shpejtë.(Ky rekomandim është i domosdoshëm pasi gjatë studimit kërkohej nga fëmijët,mësueset dhe prindërit).
- Ndërtimi i strukturave për të mundësuar njerëzit me aftësi të kufizuar të marrin pjesë në të gjithë sektorët e jetës sociale-ekonomike dhe kulturore.
- NJMDF në bashki dhe komuna të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e këtij target Grupi.
- Shërbime komunitare për fëmijët me nevoja të veçanta në cdo komunë dhe bashki të Qarkut Gjirokastrë
- Shërbim shëndetësor më cilësor në nivel bashkie dhe komune .
- Fushata informuese ,trainime me prindërit dhe fëmijët.
- Krijimi i mundësive të punësimit për një të ardhme më të mirë dhe mundësi për një integrim sa më të plotë.
- .-Krijimi i një shkolle speciale në Qark për fëmijët me AK të cilët do të vlerësohen nga komisionet multidisiplinore në DAR.

## **Anex1**

### **Disa nga çështjet të cilat u trajtuan në formën e pyetësorëve dhe intervistave në këtë studim janë:**

- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin Parauniversitar.
- Identifikimi i fëmijëve në shkolla dhe programet që zbatoheshin për integrimin e tyre.
- Realiteti i pranimi në shoqëri i kësaj kategorie .
- Roli i prindërve në bashkëpunim të ngushtë me fëmijën. arsimimin ,shërbimet,komunitetin .
- Infrastruktura e përshtatshme një nga shërbimet më të nevojshme .
- Shërbimet shëndetësore të ofruara dhe ndikimi i këtij komponenti të rëndësishëm në cilësinë e jetës.
- Shërbimet në qendrat ditore të cilat ofrojnë shërbime në Qarkun Gjirokastrë dhe ndikojnë në zhvillimin , edukimin dhe formimin e fëmijës .
- Strategjitë dhe praktikat e ndërmarra dhe të zbatuara në Qark.
- Tablo sa më e qartë e situatës të fëmijëve me nevoja të veçanta ,rekomandime ,ndërrhyrje, përmirësime,planifikime .
- Pajisja me të dhëna statistikore në DAR ,DSHP,SHSSH dhe paraqitja në tabela dhe grafikë.
- Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në kurset e formimit profesional ?

### **Bibliografia**

- Konventa mbi të drejtat e fëmijëve
- Strategjia Kombëtare për Njerëzit me aftësi të kufizuara 2004 – 2015
- Ligji për Arsimin Parauniversitar, 2012
- Të dhëna nga DRSHSSH Gjirokastrë
- Ministria e Brendshme , Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile Tiranë 2013
- Konventa mbi të drejtat e PAK 2010
- Të dhëna nga DRSHHP Gjirokastrë
- Dispozitat Normative për Arsimin para-universitar
- Raport “ realizimi i të drejtave të Fëmijëve në Shqipëri 2008-2009” Aleanca Kombëtare për Fëmijët/ Observatori Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve, 2010.
- Strategjia e Zhvillimit të Qarkut Gjirokastrë 2005-2015